



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3769 prot.

Tiranë, më 11.09.2024

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

DREJTOR I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE , NË QENDRËN E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve Arsimore. Drejtori i Drejtorisë punon nën drejtimin e Drejtorit të QSHA-së, ndihmon në orientimin e punës që ka si qëllim organizimin, përpilimin e planeve, sigurimin e kryerjes së detyrave, lehtësimin e qarkullimit të informacioneve, si dhe siguron një bashkëpunim të mirë me kolegët e punës dhe grupet e ndryshme që mund të ndihmojnë në kryerjen e detyrave të drejtorisë. Në këtë kuadër përfaqësohet një game e gjerë detyrash që mund të lindin edhe gjatë zhvillimit të drejtorisë.

2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia që kërkohet për këtë vend pune janë:

- ✓ Diplomë universitare, Master Shkencor në fushën e Informatikës/Drejtesisë/Ekonomisë
- ✓ Eksperiencë pune mbi pesë vite.
- ✓ Njohja e mirë e legjisllacionit arsimor dhe politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave.
- ✓ Aftësi për analizën e të dhënave cilësore ose sasiore, dhe shkrimin në formën e shkrimit akademik.
- ✓ Aftësi e të dëguarit, shkrimit dhe të folurit në mënyrë efektive.
- ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi të mira për komunikim në gjuhën angleze.
- ✓ Aftësi në Përdorimin e Kompjuterit;
- ✓ Aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
- ✓ Aftësi të mira ndër personale, për të punuar në ekip dhe të marrë iniciativa.
- ✓ Aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta.
- ✓ Aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
- ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Paga për pozicionin është në kategorinë II-1.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 25.09.2024 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALLIU

